



Prishtinë: 20.12.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1087_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1749_12_17**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **23.11.2018**.

në seancën e mbajtur më datë 20.12.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit B. B. nga fshati Harilaq, me shifër të konsumatorit: DFE - 9024186 ndaj vendimit të DMK-së, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1749_12_17** i datës 13.12.2017.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 24.08.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori B.B, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se në kohën kur KEDS ka ndërruar njehsorin i ka pasur 3 pajisje ndërsa pasi është vendosur prapë shpenzimet janë të njëjta madje edhe më larta edhe pse posedon pajisje më shumë. Konsumatori në ankesë ka theksuar se dyshon në njehsorin paraprak që nuk ka qenë në rregull.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 20.12.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkalës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE ka analizuar me kujdes procesverbalin e ndërrimit dhe heqjes së njehsorit elektrik nr.0122097 të datës 03.02.2015, si dhe procesverbalin e inspektimit nr.0649705 të datës 07.12.2015 dhe ka vërejtur se shpenzimet në njehsorin elektrik nr.73538961 të regjistruara në procesverbal përputhen plotësisht me faturimin e periudhës nëntor 2015.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se shpenzimet e energjisë elektrike i ka pasur të larta me njehsorin elektrik edhe pse ka pasur vetëm 3 pajisje, Bordi i ZRRE thekson se ka analizuar me kujdes shpenzimet e energjisë elektrike të konsumatorit dhe konstaton se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore. Bordi i ZRRE ka analizuar shpenzimet e energjisë elektrike



për periudhat kontestuese me njehsorin elektrik nr.73538961 dhe ka krahasuar me shpenzimet e regjistruara në njehsorin e ri nr.64684780, si dhe njehsorin elektrik paraprak nr.44143247 dhe ka vërtetuar se konsumatori ka luhatje në shpenzim të energjisë. Lidhur me këtë, me qëllim që të paraqiten sa më qartë shpenzimet e konsumatorit është bërë analizimi i konsumit të energjisë së konsumatorit me tre njehsorët elektrik për periudha të njëjta kohore. Me njehsorin elektrik nr.44143247 për periudhën 07/2012 deri në periudhën 12/2013 mesatarja mujore e shpenzimit është 225 kWh/muaj, me njehsorin elektrik nr.73538961 për periudhën 07/2014 deri në periudhën 11/2015 mesatarja mujore e shpenzimit është 520 kWh/muaj, si dhe me njehsorin e ri elektrik nr.64684780 për periudhën 07/2016 deri në periudhën 11/2017 mesatarja mujore e shpenzimit është 429 kWh/muaj. Pra Bordi i ZRRE thekson se sipas krahasimit të bërë konstatohet se konsumatori me njehsorin kontestues nr.73538961 ka pasur shpenzim më lartë krahasuar me shpenzimet në njehsorin paraprak nr.44143247, dhe me njehsorin e ri nr.64684780, por qëme njehsorin e ri nuk ka ndonjë rritje të madhe e cila do të duhej të veçohej, si dhe bazuar në protokollin mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik Nr. org. 02 nr. 182 datë 08.01.2016 nuk vërtetohet se njehsori elektrik nr. 73538961 ka qenë jo në rregull.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se dyshon në saktësinë e njehsorit elektrik, Bordi i ZRRE thekson se punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë shqyrtimin e saktësisë së matjes së njehsorit elektrik nr.73538961, dhe gjatë shqyrtimit kanë konstatuar se gabimi në matje të njehsorit elektrik nr.73538961 është **-0.20%**. Bazuar në të gjeturat përkatësisht shqyrtimin e saktësisë së matjes nga qendra e kalibrimit për njehsorin elektrik nr.73538961 është konstatuar se gabimi në matje është brenda kufijve të lejuar matës me çka edhe vërtetohet se njehsori elektrik i konsumatorit ka bërë matje të saktë. Po ashtu në protokollin mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik punëtorët e autorizuar nuk kanë evidentuar çfarëdo dëmtimi të njehsorit elektrik.

Bordi i ZRRE-së thekson se bazuar në transaksionet e konsumatorit dhe rrjedhën e energjisë elektrike konstaton se KESCO/KEDS ka respektuar nenin 28 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku thuhet se:” 1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat e tjera, në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Furnizuesi ose Operatori i Sistemit për konsumatorët me tarifa të rregulluara në bazë të tarifave të miratuara nga ZRRE-ja, dhe për konsumatorët e kualifikuar (me çmime të parregulluara) ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim”

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20.12.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit B. B.
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.